


Raporti i dytë për punën e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit

(Tetor - Dhjetor 2019)

Authorë: Martina Ilievska



Përmbajte

Rezyme	1
Raste me dyshim për korrupsion dhe konflikt të interesave të punuara nga komisioni gjatë vitit 2019	2
Analizë e rezultateve	5
Ndjekje e proceseve zgjedhore	17
Procedim dhe vendim-marrje për lëndët e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit	19
Qasje metodologjike	21
Përshkrim i variablave	22
Rezyme e shkurtër	26
Bibliografi	27

Impressum

Titull: Raporti i dytë për punën e Komisionit shtetëror
për pengim të korrupsionit

Botues: Institutit për Demokraci
“Societas Civilis” – Shkup

Authorë: Martina Ilievska

Përkthim: Mustafa Peza

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Ky publikim është i disponueshëm në:
<http://www.idscs.org.mk>

Projekti “Monitorimi i suksesit të punës së Komisionit Shtetëror për Mbrojtje nga Korrupsioni” është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni. “Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe grantuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur-Maqedoni”.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

35.072.2:343.352(497.7)“2019*10/*12”(047.31)

ILIEVSKA, Martina

Raporti i dytë për punën e Komisionit shtetëror për pengim të
korrupsionit : (Tetor - Dhjetor 2019) / Martina Ilievska. - Shkup :
Institutit për demokraci Societas Civilis, 2020. - 28 стр. : граф.
прикази, табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 28

ISBN 978-608-4775-71-3

а) Државна комисија за спречување корупција - Транспарентност -
Македонија - 2019*10/*12 - Истражувања

COBISS.MK-ID 112476682

Rezyme

Qëllimi kryesor i monitorimit është përcjellje e vendimeve të miratuara në seancat publike, të Komisionit Shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK), i cili është trup parandalues dhe ka funksion që të pengojë që të ndodh korrupsioni. Përcjellja e KSHPK në kuadër të projektit "Monitorimi i KSHPK-së, në kuadër të projektit "Vëzhgimi i suksesit të punës së Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit", zhvillohet në dy faza. Faza e parë është nga fillimi i punës së përbërjes së re të komisionit, përkatësisht pas miratimit të vendimeve të para, në mars të vitit 2019 deri në shtator të vitit 2019-të, ndërsa faza e dytë është deri në fund të vitit 2019-të përkatësisht për tre muajt e mbetura, të cilat nuk janë të përfshira me raportin e parë nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019. Të dhënat, mbi të cilat mbështetet ky raport, janë grumbulluar nga sajti i Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit si dhe të informacioneve, që janë marrë me dërgim të kërkesave për qasje në informacionet me karakter publik në adresë të KSHPK.

Në këtë raport janë analizuar tre muajt e fundit në vitin 2019 në të cilat KSHPK ka mbajtur dy seanca dhe ka miratuar **96 vendime**.

Për pothuajse një vit komisioni ka formuar 1165 lëndë

Gjatë vitit 2019 komisioni ka formësuar gjithsej 1165 lëndë, nga të cilat 710 janë formësuar nën dyshimin për korrupsion ndërsa 455 me dyshim të konfliktit të interesave. Gjatë këtij viti janë zgjidhur 100 lëndë me dyshim për korrupsion dhe 199 për dyshim për konflikt të interesave.

Numri më i madh i vendimeve të miratuara në këtë periudhë janë në fushën e shëndetësisë

Nën dyshimin se ka veprime joligjore në institucionet të cilat japin shërbime shëndetësore dhe/ose janë pjesë e sistemit shëndetësor janë 26% të vendimeve që janë marrë. Pjesa më e madhe e rasteve nga fusha e shëndetësisë ka të bëjë me procedurat gjatë punësimit dhe në kontrollin e rregullt të KSHPK të fletëve anketuese për gjendjen pronësore të bartësve të funksioneve. Pjesa më e vogël e vendimeve të miratuara janë nga fusha e **shërbimeve publike 13%** dhe fusha **organe të zbatimit të ligjit 15%** nga vendimet e miratuara.

Punësimi dhe kontrolli i interesave dhe të pronës në fokusin e KSHPK-së në muajt e fundit të vitit 2019

Komisioni gjatë dy seancave të fundit në vitin 2019, më shumë vendime ka miratuar për procedura të ndërlidhura me korrupsionin ose konfliktin e interesave gjatë punësimit, të cilat janë pothuajse gjysma, përkatësisht **46%** nga numri i përgjithshëm i vendimeve.

Një përcaktim i shkeljes së ligjit dhe një vërejtje publike

Për një nga rastet, për të cilat është miratuar vendim në periudhën e analizuar, është konstatuar shkelje e Ligjit, ndërsa për 26% nga vendimet nuk janë konfirmuar dyshime për korrupsion ose

konflikt të interesave. Komisioni shtetëror, në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, mund t'i shqiptojë masë vërejtje publike personit, i cili është zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta, kështuqë në periudhën nga tetori i vitit 2019 deri në janar të vitit 2020 ka sjellë një vendim për shqiptim të masës – vërejtje publike.

Një lëndë nga 96 vendime ka filluar me iniciativë vetanake të KSHPK

Të dhënat e publikuara në faqen e KSHPK-së për periudhën nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019 tregojnë se një pjesë e madhe e vendimeve nuk përmbajnë informacion nga kush ka filluar iniciativa (parashtrues i panjohur, paraqitje anonime, i panjohur, iniciativë vetanake e ngjashëm). Në 38% të vendimeve është lënë anësh informacioni për parashtruesin të iniciativës dërguar KSHPK-së. Pothuajse një e treta e vendimeve janë miratuar për iniciativa të filluara nga parashtrues i njohur 27%, ndërsa vetëm për 1% të vendimeve janë miratuar me iniciativë vetanake të komisionit dhe në sajë të njohurive nga mediet.

Pesë muaj e gjysmë kanë qenë të nevojshme për komisionin që ti përfundojë procedurat për të cilat ka sjellë vendime në seancat e fundit të vitit 2019

Periudha kohore nga miratimi i iniciativës deri më miratimin e vendimit në dy seancat e fundit të KSHPK-së në vitin 2019 është 5 muaj e 14 ditë, me ç'rast numri minimal i ditëve për procedurë të plotë është 42 ditë, ndërsa numri maksimal është shënuar në periudhën që është përcjellë 273 ditë. KSHPK mund të shqiptojë masa, të cilat janë në kompetencën e saj, ndërsa në periudhën e monitorimit KSHPK ka shqiptuar masë kundërvajtëse dhe fletë urdhëresë pagesore në 24% të vendimeve.

Procedura me dyshim për korrupsion dhe konflikt të interesave të punuara nga komisioni gjatë vitit 2019

Puna e Komisionit shtetëror bazohet në Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesit ku janë të përshkruara dispozitat për zgjedhje të anëtarëve të komisionit, fushëveprimi i punës dhe funksionimi i brendshëm.

Për tu bërë përmbledhja e punës vjetore të komisionit u kërkuan informacione, përmes kërkesave për qasje në informacione me karakter publik, në të cilat institucioni u përgjigj në afatin e parashikuar me afatin e paraparë.

Lëndë me dyshim për korrupsion

Sipas të dhënave, komisioni gjatë vitit 2019, në kuadër të kompetencave të veta ligjore, ekziston dyshim për korrupsion, i cili ka **formuar 710** lëndë, nga të cilat 687 lëndë janë të formuara në sajë të parashtresës së dhënë ndërsa 23 lëndë me iniciativë vetanake.

Nga lëndët e formuara në vitin 2019 **janë zgjidhur 100 lëndë** me dyshim për korrupsion, ndërsa komisioni në 15 nga rastet, ka ngritur procedurë para institucioneve të tjera kompetente, nga të cilat gjashtë iniciativa për ngritje të procedurës për ndjekje penale dhe nëntë iniciativa për përcaktimin e përgjegjësisë.

Komisioni nuk ka obligim ligjor që ti kategorizojë

rastet sipas shkallës së shkeljes, përkatësisht korrupsion të ulët, të mesëm ose të lartë. Në pajtim me dispozitat ligjore komisioni nuk mban evidencë të kategorizuar për lëndët e formuara dhe rastet e zgjidhura.

Lëndë me dyshim për konflikt të interesave

Në dhjetë muajt e para të punës së përbërjes së re të komisionit për anti-korrupsion, përkatësisht deri në fund të vitit 2019, **janë formuar 455** lëndë me dyshim për ekzistimin e konfliktit të interesave, nga të cilat 199 janë të mbyllura ndërsa të tjerat janë në vazhde e sipër. Në muajin e parë të vitit 2020 janë formuar 17 lëndë me dyshim për konflikt të interesave, në sajë të paraqitjeve, kërkim të mendimeve dhe një lëndë me iniciativë vetanake, dhe të gjitha lëndët janë në vazhde e sipër.

Në vitin 2019, me iniciativë vetanake për dyshim të konfliktit të interesave, janë formuar 66 lëndë, prej tyre 29 janë në vazhde e sipër ndërsa 37 janë të mbyllura. Në sajë të paraqitjeve, kërimit të mendimeve të qytetarëve, janë formuar 364 lëndë nga të cilat 221 janë në vazhde e sipër ndërsa 143 janë të mbyllura. Gjatë vitit 2019, ka pasur 25 procedura të rregullta për kontroll të deklaratave


për interesa, nga të cilat 6 janë në vazhde e sipër, ndërsa 19 janë të mbyllura.

ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së personit zyrtar në institucionet kompetente.

Për 15 nga procedurat e punuara në vitin 2019 Komisioni e ka vazhduar procedurën në institucion tjetër kompetent dhe ka parashtruar iniciativë për

Pasqyrë e detajuar, e procedurave me dyshim për korrupsion dhe konflikt të interesave për vitin 2019, është prezantuar në grafikun 1.

Grafiku 1. Fusha të vendimeve të miratuara të KSHPK



Analizë e rezultateve

Pjesa më e madhe e vendimeve të miratuara janë nga fusha e shëndetësisë


Gjatë tre muajve të fundit të vitit 2019, KSHPK ka miratuar numër më të madh të vendimeve të cilat janë në fushën e **shëndetësisë 26%**, përkatësisht janë të iniciuara nën dyshimin se shkelja e ligjit është bërë në institucionet të cilat japin shërbime shëndetësore dhe/ose janë pjesë e sistemit shëndetësor. Pjesa më e madhe e rasteve, nga fusha e shëndetësisë, kanë të bëjnë me procedurat e gjendjet pronësore të bartësve të funksioneve. Periudha mesatare kohore nga fillimi i procedurës deri në mbylljen e procedurës në fushën shëndetësi - e cila ka miratuar numër më të madh të vendimeve është 2 muaj.

Pjesa më e vogël e vendimeve të miratuara janë nga fusha e **shërbimeve publike 13%** dhe fusha **organe për zbatimin e ligjit 15%** nga vendimet e miratuara.

Në tre muajt e analizuara të fundit të vitit 2019 asnjë nga vendimet e miratuara të KSHPK nuk kanë të bëjnë me disa fusha: Biznes dhe financa; Sport; Medie; Bujqësi; ose Minerale dhe lëndë të para.

Pasqyrë e detajuar, sipas fushës së vendimeve të miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës, është shfaqur në grafikun 2.

Grafiku 2. Fusha e vendimeve të miratuara të KSHPK



Pothuajse gjysma e vendimeve të miratuara kanë të bëjnë për procedura të ndërlidhura me punësimin ose marrëdhëniet e punës


Komisioni në dy seancat e fundit në vitin 2019, më shumë vendime ka sjellë për procedura të ndërlidhura me korrupsionin ose konfliktin e interesave gjatë punësimit, të cilat janë pothuajse gjysma, përkatësisht **46%** nga numri i përgjithshëm i vendimeve.

Në të njëjtën periudhë, **24%** nga vendimet kanë të bëjnë me kontrollet e bëra të interesave dhe të pronës, procedurë ku komisioni kontrollon

nëse persona të caktuar të zgjedhur ose të emërtuar në mënyrë përkatëse i kanë plotësuar fletët anketuese dhe deklaratat e interesit. Në të njëjtën kohë, KSHPK e kontrollon edhe besueshmërinë e të dhënave.

Pasqyrë e detajuar sipas llojit të shkeljeve në vendimet e miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 3.

Grafiku 3. Pasqyrë sipas llojit të shkeljeve në vendimet e miratuara nga KSHPK



Komisioni shtetëror vetëm në një rast ka përcaktuar parregullsi dhe shkelje të ligjit

Komisioni zbaton një varg të "hapave" nga parashtrimi i iniciativës, me dyshim për shkelje të ligjit, deri në fillim të procedurës dhe të marrjes së vendimit përfundimtar.

Iniciativa e marrë i shpërndahet anëtarit të komisionit i cili fillon procedurë përgatitore. Pas përfundimit të procedurës përgatitore, anëtari,

tek i cili është shpërndarë paraqitja, i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale të cilat i ka në dispozicion, pas së cilës konstatojnë nëse ka elemente për fillim të procedurës.

Pothuajse një e katërta - **22%** nga rastet janë mbyllur pikërisht në procedurën përgatitore, sepse është konstatuar se nuk ka elemente të

mjaftueshme dhe të dhëna për fillim të procedurës. Me përfundimin e veprimeve procesuale, grumbullimi i të dhënave të nevojshme dhe fillimi i procedurës, anëtar i komisionit, i cili e udhëheq rastin, e përcakton gjendjen faktike dhe përgatit projekt vendimin me dokumentacion përcjellës dhe ia dërgon Kryetarit të komisionit, pas së cilës lënda vendoset në rendin e ditës.

Pjesa më e madhe e vendimeve, të cilat i sjell komisioni në periudhën e analizuar, kanë të bëjnë me rastet të cilat nuk janë të bazuara, përkatësisht ku nuk janë konfirmuar dyshime për korrupsion ose konflikt të interesave, përkatësisht 26% nga lëndët. Në periudhën e analizuar komisioni ka konkluduar se nuk ka kompetencë në 19% të vendimeve të miratuara ndërsa në një rast ka konstatuar shkelje të Ligjit.

Rasti, në të cilin komisioni ka konstatuar parregullsi dhe shkelje të Ligjit, ka të bëjë me dyshimet për parregullsi dhe korrupsion gjatë punësimit në një komunë. Në vendimin në këtë rast qëndron: ***“të kërkohet nga Inspektorati Shtetëror Administrativ të paraqesë një Nismë për të ngritur një procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së Kryetarit të Komunës për shkak të dyshimit për shkelje të dispozitave të Ligjit për marrëdhënie pune”***.

Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit paraqet një trup parandalues dhe në pajtim me dispozitat ligjore ka kompetenca të kufizuara për zbatim të masave gjatë shkeljes së ligjit. Në pajtim me dispozitat ligjore¹ komisioni mund të shqiptojë masë kundërvajtëse, fletë-urdhëresë kundërvajtëse

pagesor ose procedurë për barazim. Masa të këtilla janë të shqiptuara në **24%** nga vendimet dhe kanë të bëjnë për parregullsitë gjatë dhënies së të dhënave në pyetësorët anketues për bartës të funksioneve.

Komisioni ka proceduar për shkak të mos-përmbushjes së obligimit ligjor për parashtrim të fletës së anketimit, në pajtim me nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave gjatë tërë vitit.

Shikuar për nga ana kumulative, nga shkurti i vitit 2019 deri në janar të vitit 2020 janë lëshuar **75** fletë-urdhëresa pagesore për kundërvajtje të bërë për shkak të mos-përmbushjes së obligimit të plotësimit dhe të dërgimit të fletës anketuese. Në periudhën në fjalë, në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave dhe Ligjit për kundërvajtje, komisioni ka parashtruar gjithsej **11 kërkesa** për zbatim të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje, të bërë për shkak të mos-përmbushjes së obligimit ligjor.

Komisioni shtetëror në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave,² neni 77, mund t'i shqiptohet masë e vërejtjes publike personit i cili është zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta. Në periudhën nga tetori i vitit 2019 deri në janar të vitit 2020 komisioni ka miratuar një vendim për shqiptim të masës – vërejtje publike³, mirëpo ajo nuk është publikuar si vendim në seancë. Në pajtim me të dhënat, që janë marrë në raportin e parë për punën e KSHPK-së ku, në periudhën nga shkurti i vitit 2019 deri në tetor të vitit 2019, gjithashtu është shqiptuar një masë e

¹ Ligji për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave, Numri i Gazetës Zyrtare: 12/2019


² Ligji për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave, Numri i Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut: 12/2019 (neni 77)

³ Të dhëna të siguruara përmes kërkesës së parashtruar për qasje në informacionet me karakter publik

vërejtjes publike, mund të shihet se për pothuajse një vit vetëm dy persona që janë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta, u është shqiptuar një masë e tillë.

Pasqyrë e detajuar sipas statusit të vendimit të miratuar në vendimet e miratuara nga KSHPK të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 4.

Grafiku 4. Pasqyrë sipas statusit të vendimit të miratuar në vendimet e miratuara nga KSHPK



Komisioni ka lëshuar 21 fletë-urdhëresë kundërvajtëse pagesore, për procedura në fushën e shëndetësisë

Pjesa më e madhe e vendimeve të miratuara nga fusha e shëndetësisë janë të mbyllura, me ç'rast vendimi i KSHPK-së ka lëshuar fletë-urdhëresë pagesore kundërvajtëse – **84%** (21 vendim). Gjatë sjelljes së vendimeve në fushën e organeve për zbatimin e ligjit më shpesh KSHPK është sqaruar se nuk është institucion kompetent për

procedurë të mëtejme – 11 nga rastet për të cilat është miratuar vendim.

Pasqyrë e detajuar sipas numrit të vendimeve, në krahasim me fushën dhe statusin e vendimeve të miratuara nga KSHPK, të cilat janë lëndë e analizës, është prezantuar në tabelën 1.

Tabela 1. Status i vendimit sipas fushës dhe llojit – numër i rasteve		VENDIME SIPAS FUSHËS DHE STATUSIT – NUMËR I RASTEVE								
		NUK KA TË DHËNA TË MJAFTUESHME PËR PROCEDURË	E HEDHUR POSHTË/E REFUZUAR	E KONFIRMON/E MIRATUAR	NDRYSHIM I GJENDJES FAKTIKE	NUK KA KOMPETENCË	TË PABPABAZA/TË KONFIRMUARA	KUNDËRVAJTËSE	TË VJETËRSUARA	TANIMË ËSHTË PROCEDUAR NGA KSHPK
FUSHË	Parti politike	4	1				1			
	Gjyqësi	2				1	6		1	
	Shëndetësi	2					2	21		
	Ndërtimtari dhe ambient jetësor	1				1	2			
	Biznes dhe financa	1					1	1		
	Organe të zbatimit të ligjit		1			11	2			
	Energjetikë	1				2	1			
	Arsim				1		4			
	Koncesione						1			
	Bujqësi						1			
	Shërbime publike	4		1		2	3	1		1
	Vetëqeverisje lokale	4			2					1
	Tjetër	2				1	1			
	Medie									
	Minerale dhe lëndë të para									
	Sport									

Pyetësor anketues më së shumti janë kontrolluar në fushën e shëndetësisë

Në pajtim me Ligjin për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave⁴, neni 85, komisioni shtetëror mban regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar, persona përgjegjës në ndërmarrje publike, institucione publike dhe persona të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror. Gjatë muajve të fundit të vitit 2019 dhe muajit të parë të vitit 2020 në adresë të KSHPK-së janë parashtruar **285 fleta anketuese** të personave të zgjedhur ose të emërtuar nga persona përgjegjës në ndërmarrje publike, institucione publike ose persona të tjerë juridik, të cilët disponojnë me kapital shtetëror. Nëse shihet nga ana kumulative, të dhënat e fituara nga raporti i parë dhe i dytë të monitorimit të komisionit, mund të konstatohet se për më pak se një vit komisionit i janë parashtruar më tepër se 800 fletë anketuese⁵.

Nëse krahasohen lloji dhe fusha e vendimeve të miratuara mund të vërehet se në fushën e shëndetësisë, 22 nga 25 vendime kanë të bëjnë me kontrollin e pyetësorëve anketues, ndërsa tre janë vendime të ndërlidhura me dyshime për korrupsion ose konflikt të interesave në punësim. Nga ana tjetër, midis tetorit dhe dhjetorit, kur KSHPK ka vendosur për raste të ndërlidhura me punësimin, më së shumti kanë punuar në lëndë të ndërlidhura me institucione nga “zbatimi i ligjit” (law enforcement), 14 nga gjithsej 44 vendime të miratuara në llojin e punësimit.


Pasqyrë e detajuar sipas numrit të vendimeve, krahasim i fushës dhe llojit të shkeljes, të vendimeve të miratuara nga KSHPK, është prezantuar në tabelën 2.

⁴ Ligj për pengim të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave, Numër i Gazetës Zyrtare: 12/2019 (neni 120)

⁵ Të dhëna të siguruar përmes kërkesës së parashtruar për qasje në informacione me karakter publik

Tabela 2. Krahasim i fushave dhe llojit të shkeljes (nga numri i përgjithshëm)		VENDIME SIPAS FUSHËS DHE LLOJIT TË SHKELJES – NUMËR I RASTEVE							
		Financa publike	Mbikëqyrje	Punësim	Kontroll i intereseve dhe pronë	Ndikesë mbi regullativën	Kumulim i funksioneve	Tjetër	Gjithsej
LLOJ I SHKELJES FUSHË	Parti politike	3		3					6
	Gjyqësi		9	1					10
	Shëndetësi			3	22				25
	Ndërtimtari dhe ambienti jetësor	2	1				1		4
	Biznes dhe financa	1		1			1		3
	Medie								0
	Organe të zbatimit të ligjit			14					14
	Energjetikë	1	1	2					4
	Arsim			4				1	5
	Koncesione	1							1
	Bujqësi	1							1
	Minerale dhe lëndë të para								0
	Sport								0
	Shërbime publike	1	1	9	1				12
	Vetëqeverisje lokale			4		1	2		7
	Tjetër			3				1	4
	GJITHSEJ	10	12	44	23	1	4	2	96

Grafiku 5. Krahësim i llojit të shkeljes në fushat



KSHPK ka miratuar vetëm një vendim për lëndë të filluar me iniciativë të tyre


Vendimet e miratuara nga KSHPK duhet të përmbajnë informacion se nga kush është parashtruar iniciativa (iniciativë vetanake, parashtrues i (pa)njohur, paraqitje anonime dhe ngjashëm) për fillim të procedurës me dyshim për ndonjë farë shkelje të ligjit. Prapëseprapë të dhënat e publikuara në faqen e KSHPK-së për periudhën nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019 tregojnë se një pjesë e vendimeve nuk përmbajnë informacion nga kush është nisur iniciativa (parashtrues i njohur, anonime, i panjohur, iniciativë vetanake e ngjashëm). **Në 38%** nga vendimet është lënë anësh informacioni për parashtruesin e

iniciativës që i është dërguar KSHPK-së.

Më tepër se një e katërta e vendimeve (27%) janë të parashtruara nga parashtrues i njohur, ndërsa 11% me iniciativë të parashtruesit të panjohur. Për 15% nga vendimet theksohet se iniciatori ka dashur të mbetet anonim. Një pjesë e vogël e vendimeve të cilat janë miratuar (1%) kanë filluar me iniciativë vetanake të komisionit dhe në sajë të asaj që është kuptuar nga mediet.

Pasqyrë e detajuar sipas iniciatorit të procedurave të KSHPK-së të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 6.

Grafiku 6. Pasqyrë sipas iniciatorit të procedurave të KSHPK-së



Pesë muaj e gjysmë kanë qenë të nevojshme nga fillimi i procedurës deri në miratimin e vendimit në seancat e fundit për vitin 2019 të DKSHK


Periodha mesatare nga parashtrimi i iniciativës deri në miratimin e vendimit në dy seancat e fundit të KSHPK-së në vitin 2019 është **5 muaj e 14 ditë**. Numri minimal i ditëve për procedurë të plotë është 42 ditë, ndërsa periodha maksimale e procedimit është 273 ditë.

Në këtë periudhë është përfshirë procedura

përgatitore për të konstatuar nëse ka elementë për procedurë, veprime procesuale gjatë procedurës së përcaktimit të gjendjes faktike dhe për miratim të vendimit në seancë publike të KSHPK-së.

Pasqyrë e detajuar e ditëve të miratimit të vendimeve të KSHPK-së të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në grafikun 7.

Grafiku 7. Pasqyrë e ditëve për miratim të vendimeve të KSHPK-së



Efikasitet në vendimarrje

Efikasitetin e KSHPK-së mund ta analizojmë në disa nivele. Niveli i parë i efikasitetit është numri i rasteve të hapura dhe të mbyllura. Nga të dhënat të cilat i siguroi institucioni, nga gjithsej 1.165 lëndë të formuara, janë mbyllur 299, që paraqet efikasitet prej 26%. Thënë shkurtimisht, nga çdo lëndë e katërt mbyllet diç më tepër se një. Kjo qartë vë në pah nevojën për rritje të numrit të të punësuarve në KSHPK për tu shtuar numri i lëndëve të mbyllura.

Nënkuptohet fusha në të cilën punon KSHPK nuk është fushë në të cilën shpejtësia është vendimtare kështu që është e kuptueshme që nuk janë mbyllur të gjitha rastet. Mirëpo, nëse shikohen të dhënat sipas rezultatit të vendimit, atëherë mund të shihet se në

KSHPK më tepër zgjasin lëndët në të cilat në fund konstatohet se nuk ka shkelje. Më problematike është gjendja në të cilën mesatarisht lëndët në të cilat në fund ndërpriten për shkak të mospasjes së të dhënave të mjaftueshme zgjasin 115 ditë midis seancës në të cilën është hapur dhe është mbyllur lënda. E ngjashme është edhe gjendja ku mesatarisht lëndët ku në fund është konstatuar se KSHPK nuk është kompetente ka zgjatur 150 ditë ose, ndërkaq, 216 për dy lëndë ku është konstatuar se tanimë kanë proceduar.

Pasqyrë e detajuar i Numrit të ditëve të shpenzuara për vendim sipas rezultatit/statusit të vendimit, është prezantuar në tabelën 3.

Tabela 3. Krahësim i ditëve të kaluara për vendim sipas rezultatit / statusit të vendimit

Status i vendimit	Numri mesatar i ditëve
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme	115
Të hedhur poshtë / të refuzuara	65
I konfirmuar / miratuar	76
Ndryshim i gjendjes faktike	113
Nuk ka kompetencë	150
Nuk ka korrupsion / konfliktit të interesave	51
Të pabaza / të pakonfirmuara	162
Kundërvajtëse	74
Vërejtje publike	147
Vjetërsim	33
Ka indice për ndryshim të gjendjes faktike	140
Ka indice, por KSHPK nuk është kompetente	63
Tanimë është proceduar nga KSHPK	216

Kjo e vë në pah nevojën e optimizmit të procesit punues ku këto lëndë do të zgjasin një periudhë më të shkurtër. KSHPK shumë shpejtë në mënyrë administrative ti mbyll lëndët ku nuk kanë kompetencë dhe shpejtë ti identifikojë lëndët për të cilat tanimë është proceduar. Në atë mënyrë nuk do të ngarkohet procesi i punës as të anëtarëve të komisionit e as të shërbimit profesional. Me këtë do të kompensohej mos-efikasiteti i shkaktuar nga mungesa e kuadrit me të cilin disponon KSHPK.

E tërë kjo do të ndihmonte në përmirësimin e dimensionit më të rëndësishëm të efikasitetit,

përkatësisht në përcaktimin e përqindjes së shkeljeve të konstatuara nga numri i tërësishëm i lëndëve të mbyllura. Sipas evidencës nga monitorimi, prej 299 lëndëve, në 115 është konstatuar shkelje – pa dallim nëse është me natyrë kundërvajtëse (77) ose penale dhe kërkesë për përcaktim të përgjegjësisë (38). KSHPK nuk mund ta kontrollojë këtë vëllim (38% nga rastet në të cilat e ka përfunduar punën) sepse ka obligim që të punojë në sajë të paraqitjeve. Mirëpo, me përzgjedhje të lëndëve jo-ekzistuese, përmes paraqitjeve jo-relevante, KSHPK do ti lë vetes hapësirë për më tepër punë me iniciativë të tij.

Ndjekje e proceseve zgjedhore

Komisioni ka një varg kompetenca gjatë zgjedhjeve, të cilat burojnë nga Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit⁶ të interesave, por edhe nga Kodi zgjedhor⁷. Komisioni i përcjell proceset zgjedhore dhe në pajtim me dispozitat ligjore vepron në raport me dyshimet për shkelje të ligjeve. Gjatë zgjedhjeve komisioni ndjek disa segmente të cilat janë më të lëndueshme për veprime korruptive në procesin zgjedhor. Në pajtim me mundësitë ligjore ka kompetencë që ta ndjek ligjshmërinë e disponimit me mjetet buxhetore dhe ta ndjek ligjshmërinë e financimit të fushatave zgjedhore, të ndjek ryshfetin e mundshëm gjatë zgjedhjeve dhe votimit, në mënyrë shtesë i përcjell procedurat për furnizime publike, si dhe presionet e mundshme nga ndonjë parti politike gjatë zgjedhjes ose emërimit, ose shkarkimit të personit në funksion ose detyrë zyrtare, udhëheqëse ose tjetër. Në rast të ekzistimit për shkelje të ligjit, komisioni ngrenë procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike, e nëse konstaton se dyshimet janë

të bazuara, është i obliguar të iniciojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente.

Komisioni grumbullon edhe informacione gjatë tërë procesit zgjedhor, ndërsa pas përfundimit të zgjedhjeve harton edhe raport të posaçëm për gjendjet e konstatuara. Raportin ia dërgon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriore dhe duhet ta publikojë në ueb faqen e vet.

Në pajtim me përgjigjen që është marrë nga KSHPK, pas kërkesës së parashtruar për qasje në informacione me karakter publik, komisioni nuk ka përcaktuar Metodologji për ndjekje të gjendjeve në financimin e fushatës zgjedhore gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Përballë kësaj të dhëne, KSHPK në vitin 2020, në pajtim me ligjet kishte obligim që ti përcjell zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe financimin e fushatës zgjedhore.⁸

⁶ Ligj për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Numër i Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut: 12/2019 (neni 32)

⁷ Kodi zgjedhor, Numër i Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19 dhe 42/20) (neni 74)

⁸ Të dhëna që janë marrë përmes kërkesës për qasje në informacione me karakter publik

Procedim dhe vendimmarje për lëndët e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit

Në pajtim me rregulloren e punës, komisioni procedon në sajë të iniciativës së parashtruar ose në sajë të iniciativës së vet. Paraqitja mund të dorëzohet në formë të parashtrësës, propozimit, kërkesës e formë tjetër.

Lëndët pas dhënies së paraqitjes u shpërndahen anëtarëve të komisionit sipas rradhës alfabetike të mbiemrave, ndërsa pas çdo shpërndarjeje të tretë të lëndëve për anëtarët, i bëhet shpërndarja e lëndëve kryetarit të Komisionit shtetëror.

Në sajë të konkluzës së miratuar në seancë formësohet lëndë për procedim sipas iniciativës vetanake, lëndët e këtilla shpërndahen në të njëjtën mënyrë si lëndët nga paraqitjet e qytetarëve.

Lëndët e formuara ,në sajë të paraqitjes të parashtruar nga fërshëllues të cilat nuk janë të hedhura poshtë në procedurë paraprake, regjistrohet si lëndë e formuar me iniciativë të tyre.

Fillimi i procedurës:

Procedura ,e cila është në sajë të iniciativës vetanake, konsiderohet e filluar me ndërmarrjen e veprimit të parë procesual të anëtarit ose të kryetarit të komisionit, ndërsa procedura e filluar në sajë të paraqitjes nga qytetarë i nënshtrohet procedurës përgatitore.

Procedura përgatitore paraqet proces në të cilin anëtari ku është shpërndarë lënda heton

nëse KSHPK ka kompetencë të procedojë për pretendimet e paraqitjes, a është e kuptueshme paraqitja dhe nëse përmban elemente dhe të dhëna të mjaftueshme për ngritje të procedurës. Gjatë procedurës përgatitore sigurohen të dhënat e nevojshme nga parashtruesi në afat racional kohor.

Nëse konstatohet se KSHPK nuk ka kompetencë të procedojë në rastin konkret ose nëse paraqitja nuk i përmban informacionet e nevojshme dhe pretendimet për fillimin e procedurës, KSHPK sjell vendim për hedhjen poshtë të paraqitjes.

Ngritje dhe vazhde e procedurës në sajë të paraqitjes:

Pas përfundimit të procedurës përgatitore, anëtari te i cili është shpërndarë paraqitja, i ndërmerr të gjitha veprimet procesuale të cilat i ka në dispozicion (kërkesë e informacioneve dhe të të dhënave nga institucionet kompetente dhe persona fizik, realizimi i kontrollit në dokumentacionin, thirrje të dëshmitarëve dhe marrje e deklaratës nga personi për të cilin ka të bëjë paraqitja, thirrje e personave me ekspertizë dhe ngjashëm), për ta përcaktuar gjendjen faktike dhe miratimin e vendimit përkatës. Anëtari bashkë me person zyrtar e udhëheqin procedurën.

Gjatë tërë procedurës, për gjendjen dhe rezultatet nga veprimet procesuale, anëtari që përgjigjet për procedurën e informon Kryetarin dhe anëtarët e tjerë në kolegium.


Pas procedurës së përfunduar për lëndën anëtari përgjegjës me personin zyrtar përgatisin draft-vendim i cili i dërgohet Kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të komisionit. Draft-vendimi me dokumentacionin përcjellës të lëndës, vëhet në rend dite të seansës së Komisionit shtetëror.

Vendim:

Komisioni pas përfundimit të procedurës në seancë

të hapur sjell vendim. Nëse në procedurë nuk është konstatuar shkelje e ligjit, KSHPK sjell vendim për ndërprerje dhe e informon parashtresin (nëse i njëjti është i njohur). Nëse është konstatuar shkelje e dispozitave ligjore, për zbatimin e të cilave është kompetent komisioni, ai sjell vendim, me të cilin do të shqiptojë masë që është në kompetencën e tij ose do të parashtrojë iniciativë organeve kompetente për marrje të masave nga kompetenca e tyre.

Grafiku 8. Vazhde e procedurës së KSHPK-së



Qasje metodologjike

Kompetencat kryesore të Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit (KSHPK) është të jetë trup parandalues, i cili ka funksion që të pengojë të ndodh korrupsioni, por gjithashtu ka kompetencë të iniciojë procedura institucioneve të tjera në sistemin për anti-korrupsion. Përbërja e re e komisionit ka filluar të punojë nga 8 shkurti i vitit 2019.

Vendimet e sjella nga Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit janë bazë për monitorimin e punës. Përcjellja e KSHPK-së në kuadër të projektit, zhvillohet në mënyrë të ndarë në dy faza kohore. Faza e parë është nga fillimi i punës të përbërjes së re të komisionit dhe miratimit të vendimeve të para në mars të vitit 2019 deri në shtator të vitit 2019 ndërsa faza e dytë është deri në fund të vitit 2019, përkatësisht për tre muajt e mbetura të cilat nuk janë të përfshira në raportin e parë nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019.

Metodologjia e ndjekjes së aktiviteteve të KSHPK-së dhe përgjigjet e institucioneve, për të cilat ka lëndë të hapura ose institucionet ku janë dërguar lëndët, është hartuar gjatë punëtorisë dyditore, në të cilën morën pjesë përfaqësues të organizatave që janë pjesë e Platformës për luftë kundër korrupsionit.

Të dhënat, në të cilat mbështet raporti, janë grumbulluar nga ueb faqja e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit dhe paraqesin informacione të qasshme publikisht dhe informacione që janë marrë me dërgim të kërkesave për qasje në informacione me karakter publik dërguar KSHPK-së. Janë analizuar vendimet e miratuara nga KSHPK në periudhën nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019 në 2 seanca të mbajtura. Janë marrë edhe përgjigje përmes qasjes në informacione me karakter publik që kanë marrë nga KSHPK, për kërkesat e dërguara në janar të vitit 2020.

Përshkrim i ekzemplarit të analizës:

Lëndë e analizës janë vendimet e miratuara nga Komisioni shtetëror për pengim të korrupsionit në periudhën nga tetori i vitit 2019 deri në dhjetor të vitit 2019 dhe kërkesa për qasje në informacione me karakter publik dërguar KSHPK-së. Numri i tërësishëm i vendimeve të analizuar të Komisionit shtetëror për pengim të

korrupsionit është **N=96**.

Komisionit për pengim të korrupsionit i dërguan **21 kërkesësa** për qasje në informacione me karakter publik gjatë muajit janar të vitit 2020. Institucioni u përgjigj të gjitha pyetjeve në afatin e paraparë me ligj dhe të njëjtat ishin objekt i analizës.

Përshkrim i variablave

Vendimet janë nga të analizuarat sipas fushës në të cilën ka pasur intenca për korrupsion ose konflikt të interesave, llojeve të shkeljeve, statusit të procedurës (gjë e cila është vendosur nga KSHPK) kush e ka

iniciuar procedurën para KSHPK-së dhe kohëzgjatja e tërë procedurës. Pasqyrë e detajuar e variablave të cilat janë lëndë e analizës është dhënë në tabelat nga numri 3 deri në numrin 6.

Tabela 4.	Fusha të vendimeve të miratuara të KSHPK-së
Gjyqësi	Gjykata, organe gjyqësore, prokuroria publike, avokati i popullit, avokatia publike.
Shëndetësi	Institucione shëndetësore, qendra klinike, Enti republikan për mbrojtje shëndetësore, Fondi i shëndetësisë e kështu me radhë
Ndërtimtari dhe ambient jetësor	Kompani ndërtimore, menaxhim me ambientin jetësor, ndikesë mbi ambientin jetësor, menaxhim me mbetjet dhe depozitë e të tj., projekte infrastrukturore
Biznes dhe financa	Kompani private, banka, sigurime
Medie	Medie tradicionale dhe medie online
Organe për zbatim të ligjit	Policia, dogana, policia financiare e të tj.
Energjetikë	Ndërmarrje publike dhe kompani private të cilat punojnë në prodhimtarinë, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe të ngrohjes
Arsim	Kopshte, shkolla fillore, shkolla të mesme, institucione të arsimit të lartë
Koncesione	Kontrata për shfrytëzim të tokës dhe/ose të pronës shtetërore/komunale
Bujqësi	Subvencione, Ministria e bujqësisë
Minerale dhe lëndë të para	Miniera, ndërmarrje të cilat shfrytëzojnë lëndë të para
Sport	Federata sportive, organizata sportive, agjenci për të rinj dhe sport
Shërbime të tjera publike	Ndërmarrje publike, ofrues të shërbimeve publike
Vetëqeverisje lokale	Komuna, këshilla të komunave, kryetarë të komunave, BNJVL
Tjetër	Vendime të cilat nuk mund të kategorizohen në asnjë nga fushat

Tabela 5.	Lloji i shkeljes i cili është konstatuar në pajtim me vendimet e miratuara nga KSHPK
Ndikesë mbi regullativën	Raste ku ndikohet mbi krijimin e rregullave, politikave ose standardeve me qëllim të realizimit të interesit privat.
Financa publike	Nënkupohen raste ku me qëllim të realizimit të interesit privat keqpërdoren paratë publike përmes furnizimeve publike, subvencioneve, blerje e ngjashëm.
Punësim	Nënkupohen raste ku interesi privat realizohet përmes punësimit, si për shembull raste të klientelizmit, nepotizëm dhe patronage.
Monitorim	Nënkupohen raste ku interesi privat realizohet përmes presionit mbi strukturat për monitorim ose keqpërdorimi i tyre sistematik, dobësim ose shlyerje.
Kumulimi i funksioneve	Nënkupohen rastet ku një person kryen ose është i caktuar në dy ose më tepër funksione.
Kontrolli i interesave dhe pronës	Fletë anketuese, mos-parashtrim, jo të plota
Tjetër	Lloji i shkeljeve të cilat paraprakisht nuk janë të përfshira me kategorizimin

Tabela 6.	Status i vendimit të miratuar
Nuk ka të dhëna të mjaftueshme	Nuk ka të dhëna të mjaftueshme dhe elemente për ngritje të procedurës para organeve të tjera
E hedhur poshtë / e refuzuar	Procedura të hedhur poshtë / të refuzuara
Konfirmuar, miratuar, procedurë të mëtejme	Ka konfirmim për shkelje të ligjit, lënda është në procedurë të mëtejme
Ndryshim i gjendjes faktike	Gjatë procedurës ka ndryshuar gjendja faktike, procedura është mbyllur
Nuk ka kompetencë	KSHPK nuk ka kompetencë për të ndërmarrë masa
Nuk ka korrupsion/konflikt të interesave	Është konstatuar se nuk ka korrupsion ose konflikt të interesit
Të pa bazë, të pa konfirmuar	Të pa bazë ose të pa konfirmuar janë indicet të cilat janë të theksuara në paraqitjen e parashtruar
Kundërvajtëse	Është shqiptuar masë, paraqitje kundërvajtëse dhe fletë-urdhëresë pagesore
E hedhur poshtë	Rasti është i hedhur poshtë nga KSHPK
E pavlefshme	Procedura është e pavlefshme
Vërejtje publike	Është shqiptuar masë vërejtje publike
E pa lëndë	Është konstatuar se procedura është pa lëndë
Vjetërsim	Rasti është mbyllur për shkak të vjetërsimit të rastit
Ka indice për korrupsion, por ndryshimi nuk është gjendje faktike	Ka indice për korrupsion/konflikt të interesave, por është ndërprerë procedura për shkak të ndryshimit të gjendjes faktike gjatë procedurës
Tanimë është proceduar nga KSHPK	Komisioni ka proceduar paraprakisht për rastin

Tabela 7.	Inicimi i procedurës
Nismë vetanake	Procedura është filluar me iniciativë të KSHPK -së
Parashtrues anonim	Paraqitja është dërguar nga parashtrues anonim
Parashtrues i njohur	Paraqitja është dërguar nga parashtrues i njohur
Njohuri nga mediet	Procedura ka filluar sipas zërit të dëgjuar nga mediet
Postë elektronike	Paraqitja është marrë përmes postës elektronike
Detyrë zyrtare	Procedura është filluar në sajë të detyrës zyrtare të KSHPK-së
Parashtrues i panjohur	Paraqitja është dërguar nga parashtrues i panjohur
Parti politike	Paraqitja është dërguar nga parashtrues i panjohur
Nuk ka informacione	Nuk ka informacione në vendimet se si është iniciuar procedura

Rezyme e shkurtër

Të dhënat, në të cilat mbështet raporti, janë të qasshme publikisht në ueb faqen e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit, si dhe të dhëna që janë marrë me dërgimin e kërkesave për qasje në informacionet me karakter publik në KSHPK.

Në këtë raport janë analizuar tre muajt e fundit të vitit 2019, në të cilat KSHPK ka mbajtur dy seanca dhe janë miratuar **96 vendime**.

Pjesa më e madhe e vendimeve janë në fushën e **shëndetësisë 26%**, përkatësisht janë ngritur nën dyshimin se ka veprime joligjore në institucionet të cilat japin shërbime shëndetësore dhe/ose janë pjesë e sistemit shëndetësor.

Të dhënat e publikuara në faqen e KSHPK-së, për periudhën nga tetori deri në dhjetor të vitit 2019, tregojnë se në pjesën më të madhe të vendimeve nuk përmbajnë informacion se kush e ka filluar iniciativën dhe kjo e dhënë mungon në 38% të rasteve.

Pothuajse një e treta e vendimeve janë miratuar për iniciativa të filluara nga **parashtrues i njohur 27%**, ndërsa vetëm nga 1% të vendimeve janë miratuar me iniciativë vetanake të komisionit dhe në sajë të njohurive nga mediet.

Periodha kohore për parashtrim të iniciativës deri në miratimin e dy seancave të fundit të KSHPK-së në vitin 2019 është **5 muaj dhe 14 ditë**, me ç'rast numri minimal i ditëve për procedurë të plotë është 42 ditë, ndërsa numri maksimal i vërejtur në periudhën që është përcjellë është 273 ditë.

KSHPK mund të shqiptojë masa të cilat janë në kompetencë të saj, në periudhën e monitoruar janë se KSHPK ka shqiptuar masë fletë urdhëresë kundërvajtëse pagesore në 24% të vendimeve, ndërsa në asnjë nga vendimet e miratuara nuk kanë shqiptuar masë vërejtje publike për person të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta.

Bibliografi

Vendimet e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit janë të qasshme në linkun vijues:

<https://www.dksk.mk/index.php?id=113>

Ligji për pengim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" : 12/2019

Manual për punë të Komisionit shtetëror për pengim të komisionit, i miratuar në seancën e 20-të të mbajtur në datën 05.08.2019. Dokumenti është i qasshëm në linkun vijues:

https://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/2019-3794-1.pdf

Kodi zgjedhor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr. 98/19.

Ilievski, I. (2019). "Raporti i parë për punën e Komisionit shtetëror për pengim të korrupsionit". Instituti për demokraci "Societas civilis" – Shkup.

<https://idscs.org.mk>

Kocevski, G. (2019). „Towards accountable and transparent public administration by means of functional oversight institutions“. Foundation Open Society – Macedonia.

